



Titulli i projektit

Krijimi i "Rrugës së Verës"

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/Kohezion Social

Vendndodhja e projektit

Manëz dhe Sukth

Buxheti i paravlerësuar

21,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Zona e Manzës dhe e Sukthit janë të njohura për prodhimin e verës dhe të djathit. Por vihet re që cilësitë dhe vlera e këtyre produkteve nuk janë promovuar mjaftueshëm nga njësitë e pushtetit vendor, apo nga nisma private apo joqeveritare. Krijimi i "Rrugës së Verës", e cila kalon përmes Komunës së Manzës dhe Bashkisë së Sukthit, do të mundësojë promovimin e produkteve shtëpiake të prodhuara nga vreshtarë dhe fermerë të njësive administrative, kryesisht verës, djathit, etj..

Edhe pse turizmi në Bashkinë e re Durrës është orientuar tërësisht drejt plazhit, vihen re këto shqetësime:

- përveç plazhit të Lalzit, pjesa tjetër e linjës së detit është e dëmtuar nga zhvillimi urban;
- është përqendruar në turizëm me të ardhura të ulëta;
- është i përqendruar vetëm gjatë 2,5 muajve të vitit.

Si i tillë turizmi ka një ndikim minimal dhe nuk ka vlerë të ndjeshme të shtuar për ekonominë e zonës.

Në këto kushte, "Rruga e Verës" do të jetë një nismë e mirëpritur për të promovuar turizmin e brendshëm.

Qëllimi i projektit është promovimi i produkteve shtëpiake (si p.sh.: vera dhe djathi) të prodhuara nga vreshtarë dhe fermerë të zonës dhe promovimi i turizmit të brendshëm në Zonën Funksionale. Përmes turizmit tokësor, Bashkia Durrës mund:

- të promovojë dhe të ofrojë produkte vendase, duke ndikuar drejtpërdrejt të ardhurat e banorëve ruralë;
- të rrisë mundësitë e zgjedhjes së turistëve, duke ofruar alternativa për turizmin detar;
- të promovojë profilin e zonës;
- të bëhet tërheqëse për banorët e Tiranës, apo zonave të tjera urbane.

Rezultatet e pritshme përfshijnë: (a) krijimin e një rruge gastronomike; (b) përmirësimin i nivelit të turizmit të brendshëm në Zonën Funksionale Durrës. Krijimi i Rrugës së Verës do të ndikojë direkt në përmirësimin e jetës së banorëve të 2 (dy) njësive administrative Manëz dhe Sukth (15966 banorëve të Sukthit dhe 6652 banorëve të Manzës), kryesisht rreshtarëve dhe fermerëve që prodhojnë produkte tipike të zonës. Ndikimet pozitive të zbatimit të projektit do të ndjehen jo vetëm në këto dy njësi administrative, por në të gjithë Bashkinë e Durrësit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

PROJEKTI 7



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt për zbatimin e projektit është 6 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) identifikimin e produkteve gastronomike tipike të zonës, dhe të verës në veçanti;
- (b) identifikimin e vreshtarëve dhe fermerëve që kanë interes në prodhimin dhe promovimin e produkteve tipike;
- (c) shenjimin/markimin e rrugës;
- (d) promovimin e kësaj rruge nëpërmjet aktiviteteve promovuese dhe hartimin e materialeve promovuese;
- (e) përmirësimin e lokaleve pritëse për turistët për prodhues të përzgjedhur dhe pajisja e tyre me logo, website dhe materiale promovuese (përfshirë gota, broke, etj.),
- (f) vendosjen e hartave turistike për Rrugën e Verës në vende kyq, si porti, bashkia, etj..

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonjë studimi fizibiliteti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimi kryesor është dldp. Burimi të tjera të mundshme financimi janë skema granti të donatorëve të ndryshëm që mbështesin promovimin dhe zhvillimin e turizmit (si p.sh.: BE, UNDP, Bashkëpunimi Italian, etj.), fonde të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

Si partnerë të mundshëm në zbatimin e këtij projekti mund të përmenden Agjensia Kombëtare e Turizmit, njësitë administrative Manëz dhe Sukth, etj..

Kostot e projektit

Kostot e projektit do të jenë afërsisht 21,000 Euro.